



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022 – 2031¹

Vlerësimi I Draft Strategjisë



Përgatiti: Oaza BİNÇE, Eksperte e ekonomisë

Gusht 2022 Prishtinë, Kosovë

¹ Draft Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës, e publikuar më 23.08.2022

STRATEGJIA E ENERGJISË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Qeveria e Kosovës më 18 nëntor 2021 themeloi një grup punues për të hartuar një strategji të re për energjinë. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, mbi të cilën është duke u punuar për një kohë të gjatë, synon të dekarbonizojë tregun e energjisë deri në vitin 2050, në mënyrë dinamike të rrisë burimet e ripërtëritshme të energjisë, të krijojë kapacitete të reja për akumulimin e energjisë, të rrisë efikasitetin e energjisë dhe të mbrojë konsumatorët në nevojë dhe grupet sociale të ndjeshme ndaj tranzicionit.

Në këtë studim kemi realizuar një përmbledhje të shkurtër të strategjisë kombëtare të energjisë e cila është duke u punuar nga Qeveria e Kosovës që nga data 18.11.2021, ku kemi vlerësuar parashikimet e saj dhe kemi paraqitur pikëpamjet dhe sugjerimet e OTKT-së.

* * *

Sigurimi i energjisë së besueshme, me kosto të përballueshme, dhe të pastër është thelbësor për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe mirëqenien sociale të qytetarëve. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që të aplikojë një qasje të re planifikimi për të adresuar sfidat aktuale dhe për të vendosur themelin për një të ardhme të sektorit energjetik të vendit e cila gjithnjë e më shumë të ofrojë siguri të furnizimit me energji elektrike, energji të pastër, eficientë të energjisë, dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve e përkrahje për grupet e cenueshme.

Për shkak të mungesës së planifikimit të mirë dhe të investimeve përgjatë dekadave të fundit, sektori i energjisë në Kosovë sot përballet me sfida të mëdha, përfshirë këtu:

- Varësinë nga termocetralet e vjetra me linjit, të cilat nuk garantojnë furnizimin e rregullt me energji elektrike, as fleksibilitetin e duhur të sistemit elektroenergjetik, dhe nga ana tjetër shkaktojnë emetime të gazrave serë (GS) dhe ndotje.
- Aktualisht, pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) në konsumin e energjisë elektrike është vetëm 6.3%, ndërsa shfrytëzimi i BRE-ve në sektorin energjetik dominohet nga burimet e bazuara në biomasë që kryesisht përdoren në sektorin e ngrohjes;
- Konsumin e lartë të energjisë (dhe rrjedhimisht shpenzimet e larta për energji) në raport me BPV-në dhe me popullsinë, për shkak të një numri faktorësh, përfshirë: humbjet e mëdha në rrjet, ndërtesat joeficiente dhe pajisjet joeficiente (p.sh., për ngrohje të hapësirave dhe të ujit), si në sektorin e banimit ashtu edhe në atë komercial e publik;
- Varësinë e lartë nga sistemet e ngrohjes individuale të amvisërive, me energji elektrike ose pajisje joeficiente të djegies së drurit ose thëngjillit, gjë që rrit dukshëm si nevojën për import të energjisë elektrike, ashtu edhe emetimet e larta të gazrave serë e ndotjen e ajrit gjatë muajve të ftoftë.

Dobësia e varësisë së lartë të sistemit nga importi gjatë sezonit të ngrohjes është theksuar në veçanti gjatë krizës energjetike të pas-pandemisë në vitin 2021, e cila u përkeqësua edhe më tej si pasojë e luftës në Ukrainë në vitin 2022, duke shkaktuar lëkundje dhe çmime tejet të larta në tregun e gazit natyror dhe atë të energjisë elektrike, të papara më herët. Si pasojë Kosova u desh të paguante çmime shumë të larta për të importuar energji elektrike. Kjo krizë energjetike dëshmoi se sistemi elektroenergjetik i Kosovës ka nevojë për një transformim të thellë për t'u bërë më i qëndrueshëm, më i pavarur dhe më fleksibil. Për këtë arsye në strategjinë e re i është dhënë rëndësi e posaqme fleksibilitetit të sistemit, rritjes së eficientës së energjisë, mbrojtjes dhe fuqizimit të konsumatorëve, dekarbonizimit si dhe fuqizimit e bashkëpunimit rajonal.

1. Vizioni dhe Qëllimet

Strategjia e Energjisë për periudhën 2022 - 2031 pasqyron nevojën për zhvillime të shpejta e bindëse të sektorit të energjisë, siç parashihet në vizionin e Kosovës dhe në përputhje me qëllimet e BE-së.

Vizioni:

Një sektor energjetik pa CO2 deri në vitin 2050, i integruar në tregun Pan-Evropian, duke garantuar siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përballueshmëri për qytetarët.

Bazuar në këtë vizion dhe në analizat e bëra për sektorin e energjisë, janë përcaktuar katër synime kryesore dhe pesë objektiva strategjike (drejtimet kryesore të politikave) që sigurojnë arritjen e këtij vizioni.

I. Ofrimi i sigurisë së furnizimit mbështetet në:

- Përmirësimin e besueshmërisë së sistemit si rritja e fleksibilitetit të sistemit, modernizimin e rrjeteve, rehabilitimin e termocentraleve ekzistuese dhe sigurinë kibernetike;
- Rritjen e efijencës së energjisë për të zvogëluar kërkesën;
- Mbështetjen e dekarbonizimit dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme pasi zvogëlon varësinë nga importi; dhe
- Forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut pasi lejon qasje në burime të diversifikuara të energjisë dhe në shërbimet e rrjetit më kosto-efektive.

II. Arritja e qëndrueshmërisë dhe neutralitetit klimatik kërkon:

- Ngritjen e efijencës së energjisë për të ulur konsumin e energjisë dhe kësisoj emetimet e GS-ve, ndotjen e ajrit dhe krijimin e mbetjeve;
- Dekarbonizimin dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme për të ulur emetimet e GS-ve dhe ndotjen e ajrit në sektorin e energjisë;
- Mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve duke kufizuar ndikimin negativ të sektorit të energjisë në shëndetin e njeriut dhe ambientin.

III. Përmirësimi i konkurrueshmërisë bazohet në:

- Fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut, duke ulur çmimet e energjisë përmes tregjeve të lidhura dhe konkurruese; dhe
- Mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve, duke krijuar stimuj në anën e kërkesës për tregje më funksionale.

IV. Ruajtja e përballueshmërisë mund të arrihet duke:

- Rritur efijencën e energjisë me reduktimin e konsumit të energjisë e cila duhet të paguhet nga konsumatorët;
- Mbështetur dekarbonizimin dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme, duke mbuluar vetëkonsumin;
- Forcuar bashkëpunimin rajonal dhe funksionimin e tregut duke ulur çmimet e energjisë përmes tregjeve të lidhura mes vete dhe konkurruese; dhe
- Mbrojtur dhe fuqizuar konsumatorët me ofrimin e zgjedhjeve për konsumatorët dhe duke mbrojtur konsumatorët në nevojë, dhe duke zhvilluar shkathhtësitë e grave e burrave në përputhje me nevojat e sektorit dinamik të energjisë.

Për ti arritur këto objektiva të lartpërmendura janë vendosur edhe caqet e secilit objektiv strategjik.

Objektivi, **“Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit”** është i mundur me rritjen e fleksibilitetit të sistemit, modernizimin e rrjetit dhe zvogëlimi e humbjeve në rrjet, rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike dhe investimet në kapacitete të reja, dhe formimin e sigurisë kibernetike në sektorin e energjisë.

Caqet kryesore të këtij objektivi janë:

- Përmirësimi i cilësisë së treguesve të furnizimit: Ulja e indeksit të kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes (SAIDI) për 35% dhe Indeksit mesatar të shpeshtësisë së ndërprerjes (SAIFI) për 30% deri në vitin 2031,
- Lansimi i shërbimeve të rezervës së bazuar në treg dhe arritja e së paku 170 MW të kapacitetit të rregullimit fleksibil deri në vitin 2031,
- Zvogëlimi i humbjeve në rrjet të shpërndarjes deri në nivelet e humbjeve aktuale teknike të BE-së (9%), deri në vitin 2031,
- Rinovimi i dy njësive të Termocentralit “Kosova B” dhe së paku një njësie të Termocentralit “Kosova A” deri në vitin 2024.

Objektivi, **“Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme”** do të mundësohet me zvogëlimin e gjenerimit të energjisë elektrike me bazë linjiti dhe zhvillimin e kapaciteteve të mëdha të BRE-ve. Në këtë objektivë gjithashtu do të synohet zbatimi gradual i caktimit të çmimit të karbonit, promovimi i energjisë së ripërtëritshme në miksin e gjenerimit të energjisë elektrike si dhe promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme në ngrohje.

Caqet kryesore të këtij objektivi janë:

- Përfundimi i të gjitha përgatitjeve për zbatimin e një sistemi për caktimin e çmimit të karbonit deri në vitin 2025, duke mundësuar vendosjen e një çmimi të karbonit i cili do të rritet gradualisht deri në integrimin e Kosovës në tregun pan-Evropian dhe në Sistemin e Tregimit të Emisioneve të BE-së (EU ETS),
- Ulja e emetimeve të gazrave serë në sektorin energjetik për së paktën 32% deri në vitin 2031,
- Mbulimi i të paktën 35% të konsumit të energjisë elektrike nga BRE-të deri në vitin 2031,
- Zhvillimi i kapaciteteve të reja të BRE-ve të erës dhe fotovoltaike, për të arritur një kapacitet të përgjithshëm të instaluar të BRE-ve prej së paku 1400 MW (përfshirë këtu 100 MW të kapacitetit të konsumatorëve vetë-prodhues) deri në 2031, me mundësi të rritjes së këtij caku nëse një gjë e tillë është e mundshme.

Objektivi, **“Rritja e eficiencës së energjisë”** do të ndiqet një rrugë zhvillimi me shfrytëzim më eficient të energjisë, që çon drejt një ekonomie me intensitet më të ulët të shfrytëzimit të energjisë. Në këtë objektivë synohet përmirësimi i eficiencës së energjisë së ndërtesave si dhe promovimi i sistemeve të kogjenerimit eficient dhe ngrohjes qendrore eficiente.

Caqet kryesore të këtij objektivi janë:

- Kufizimi i konsumit final të energjisë në nivel prej 1877 ktoe në vitin 2031,
- Arritja e kursimit kumulativ të energjisë prej 283 ktoe në ndërtesa, përfshirë ndërtesat publike, private dhe komerciale deri në vitin 2031,
- Ndërtimi i 150 ndërtesave me konsum të energjisë afër zero deri në vitin 2031.

Objektivi, **”Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut”** kontribuon në sigurinë e furnizimit përmes integritit në tregje më të gjerë rajonale, derisa mbështet edhe qëllimet e përballueshmërisë dhe konkurrencës, duke optimizuar tregjet e shitjes me shumicë dhe rezervë dhe duke i bërë ato më eficientë. Në këtë objektivë synohet fuqizimi i bashkëpunimit rajonal, heqja e barrierave për funksionimin efikas të tregut si dhe aftësimi në fusha që lidhen me energjinë dhe përfshirja e grave.

Caqet kryesore për këtë objektiv strategjik janë:

- Integrimi i tregut me Shqipërinë në vitin 2023,
- Integrimi në zonën e tregut pan-Evropian në vitin 2030,
- Heqja graduale e Marrëveshjes e furnizimit me shumicë, duke filluar në 2025 më së voni,
- Rritja e numrit të diplomuarve në fusha të lidhura me energjinë duke u siguruar që së paku 25% e të punësuarve në këtë sektor do të jenë gra, deri në vitin 2031.


Objektivi, **”Mbrotjtja dhe fuqizimi i konsumatorëve”** vendos qytetarët në qendër, duke i mbështetur konsumatorët e cenueshëm në mënyrë që të mund t’i përballojnë faturat e energjisë dhe të investojnë në efikasitet të energjisë (të ndërtesave dhe pajisjeve shtëpiake) dhe zgjidhje të ngrohjes. Në këtë objektivë synohet mbrotjtja e konsumatorëve në nevojë, fuqizimi i konsumatorëve si dhe ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

Caqet kryesore për këtë objektiv strategjik janë:

- Rishikimi i skemës aktuale mbështetëse të çmimeve për programin e konsumatorëve në nevojë, dhe themelimi i programit të ri, deri në vitin 2024 dhe më pas avancimi i mëtejme i saj në një skemë të bazuar në testin e varfërisë, e lidhur me skemën e reformuar të asistencës sociale,
- Vendosja e të paktën 2 skemave të reja dedikuara konsumatorëve në nevojë (p.sh. për efikasitetin e energjisë, zgjidhjet e ngrohjes, panelet diellore, etj.) deri në vitin 2024, dhe 4 skema deri në vitin 2031,
- Zhvillimi i më shumë se 2 programeve që mbështesin projektet e komuniteteve të energjisë në efikasitet dhe vetë-konsum deri në vitin 2024 dhe më shumë se 5 programe deri në vitin 2031,
- Zbatimi i të paktën 9 fushatave vetëdijësuese dhe informuese në lidhje me energjinë çdo vit,
- Lancimi i një mjeti të krahasimit të çmimeve deri në vitin 2024 për të siguruar krahasueshmërinë e shërbimeve të ofruara tek konsumatorët.

2. Sektori i energjisë elektrike

2.1 - Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë është rritur ndjeshëm në 10 vitet e fundit. Norma mesatare vjetore e rritjes së konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike ishte 1.4%, e nxitur kryesisht nga rritja në sektorin e amvisërisë. Pra, pjesëmarrjen më të madhe në konsumin final të energjisë, me 40% në vitin 2020, e kanë amvisëritë. Kërkesa për energji e këtij sektori është rritur më së shumti që nga viti 2008, me 148 ktoe. Sektori i dytë më i madh që konsumon energji është transporti, ku konsumi i energjisë u rrit me rreth 100 ktoe në 422 ktoe. Në sektorin industrial, përdorimi i energjisë elektrike gjatë dekadës së fundit nuk ka pasur rritje, sektori industrial përdori vetëm 302 ktoe në vitin 2020. Në anën tjetër edhe pse humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë ulur në terma absolutë e relativë, ato mbeten ende tejet të larta (humbjet teknike ~12.5%) krahasuar me mesataren e BE-së (6%-8%).



Ndërsa disa kapacitete të reja të ripërtëritshme janë vënë në funksion në vitet e fundit, veçanërisht gjeneratorë të erës dhe hidrocentrale të vogla, shumica e konsumit të energjisë elektrike është përmbushur nga prodhimi i energjisë me bazë linjiti. Në dekadën e fundit, 85% deri në 95% e konsumit total ka ardhur nga këto termocentrale. Mes viteve 2010 dhe 2020, pozicionet neto të importit kanë lëvizur në mes -9% dhe +10%.

2.2- Kapaciteti I Instaluar ne Kosove - Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar në Kosovë është 1,537 MW, nga i cili 84% është me bazë linjiti. Tri njësitë e Termocentralit “Kosova A” që janë ende në funksion janë në fund të jetëgjatësisë së tyre teknike. Dy nga njësitë janë vënë në punë para më se 50 vjetësh. Kjo rezulton në një probabilitet më të lartë dhe shpeshtësi të ndërprerjeve të paplanifikuara. Pra, investimi në kapacitetet ekzistuese të linjtit është i nevojshëm për të garantuar besueshmërinë e sistemit dhe për të përmbushur standardet e kërkuara të emetimit. Njësitë e termocentralit “Kosova B1 dhe B2” do të rinovohen për të ruajtur sigurinë e furnizimit dhe për të ulur emetimet. Rinovimi i njësive të Kosovës B1 dhe B2 do të realizohet në dy faza dhe deri në fund të vitit 2024, respektivisht 2025, të dyja njësitë do të operojnë në mënyrë më eficiente e më të besueshme, duke përmbushur standardet e detyrueshme të emetimit të Direktivës Industriale të Emisioneve. Njëra nga njësitë e termocentralit “Kosova A” do të rinovohet deri në fund të vitit 2024, ndërsa vendimi për rinovim ose mbyllje të njësisë së dytë do të merret më së voni më 2024.


Njësia (njësitë)e rinovuar(a) të termocentralit “Kosova” A” do të punojnë si rezervë strategjike nga viti 2028, që do të thotë se kjo (këto) njësi do të jetë (jenë) të disponueshme në sezonin e ngrohjes kur kërkesa për energji elektrike është më e lartë, ose në raste të jashtëzakonshme si kriza e fundit energjetike. Njësia e tretë operuese e këtij termocentrali do të mbyllet përgjithmonë pasi të ketë përfunduar rinovimi i njësive të tjera të linjtit. Pritet se së paku dy njësi të linjtit do të rinovohen deri në vitin 2024 ndërsa 2-3 njësi deri në vitin 2031. Ndërsa numri i njësive të mbyllura të linjtit deri në vitin 2031 pritet të jetë 2 ose 1.

Karburanti	Emri	Viti i vënies në punë	Kapaciteti i instaluar, MW	Kapaciteti i disponueshëm, MW
Linjiti	Kosova A3	1970	200	138
	Kosova A4	1971	200	138
	Kosova A5	1975	210	138
	Kosova B1	1983	339	305
	Kosova B2	1984	339	305
Era		-	137	-
Uji		-	101	-
Diellore fotovoltaike		-	10	-
Biomasa		-	1.2	-
Totali		-	1537	-

Në anën tjetër deri në vitin 2021, kapacitete prej 137 MW të njësive të gjenerimit të erës janë vënë në punë në Kosovë, duke rezultuar në një pjesëmarrje të erës prej 9% të kapacitetit të instaluar. Edhe hidro-energji është element i rëndësishëm i sistemit elektroenergetik me pjesëmarrje prej 6.5% të kapacitetit total të instaluar.

3.BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË

Përfaqësimi i BRE-ve në miksin energjetik të Kosovës është rritur në një masë gjatë viteve të fundit. Në vitin 2020, Kosova ka tejkaluar objektivin e pjesëmarrjes prej 25% të BRE-ve. Megjithatë, pjesëmarrja e teknologjive të ndryshme të BRE-ve është e pabalancuar dhe ka dallime të konsiderueshme në pjesëmarrjen e BRE-ve në sektorë të ndryshëm. Në sektorin e ngrohjes, biomasa siguron rreth gjysmën e energjisë së nevojshme, ndërsa në sektorin e energjisë elektrike BRE-të marrin pjesë me vetëm 6.3%, të siguruar nga burimet ujore, të erës dhe në një masë të vogël nga dielli. Pjesa e BRE-ve në transport është shumë e vogël. Pjesëmarrja e automjeteve elektrike është shumë e ulët (0,05%), pasi deri në vitin 2021 janë importuar vetëm 157 automjete elektrike dhe hibride, krahasuar me rreth 333,000 makina që



përdorin si lëndë djegëse naftë ose benzinë. Aktualisht nuk ka asnjë linjë hekurudhore të elektrizuar.


4. GAZI NATYROR

Aktualisht Kosova nuk ka rrjet të transmisionit të gazit. Për ndërtimin e një interkoneksioni për t'u lidhur me sistemet e transmisionit të gazit, qoftë me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP), ose me терминаlet e gazit natyror të lëngshëm (LNG) në detin Egje apo Jon, d.m.th. përmes Maqedonisë së Veriut ose Shqipërisë, do të duheshin së paku 7-9 vjet. Gjithjashtu Kosova nuk ka infrastrukturë gazi apo fuqi punëtore të kualifikuar për këtë. Do të duheshin dekada për të ndërtuar një rrjet distribucioni (p.sh. për ngrohje, gatim, industri) për të arritur mbulimin e (disa pjesëve të) vendit. Duke marrë parasysh këtë dhe çmimet jashtëzakonisht të larta dhe pasigurinë ekonomike dhe gjeopolitike sa i përket furnizimit me gaz në Evropë në periudhën e luftës në Ukrainë (dhe pas saj), sigurimi i diversifikimit të burimeve të energjisë bazë ose të fleksibilitetit të sistemit përmes zhvillimit të rrjetit të gazit në vend do të ishte investim i kushtueshëm e me rrezik të lartë. Megjithatë, zhvillimet në rajon dhe botë do të ndiqen me kujdes, dhe (bashkë) investimi në impiante të energjisë nga gazi për ngarkesën bazë dhe/ose fleksibilitetin e sistemit në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Greqi do të shqyrtohet me qëllim të zbatimit deri në vitin 2031.

Sektori i ngrohjes

Sektori i ngrohjes konsumon më shumë energji se çdo segment tjetër i sistemit elektroenergetik të Kosovës. Burimet kryesore për ngrohje janë biomasa (kryesisht dru zjarri) dhe energjia elektrike, ndërsa qymyri, gazi i lëngëzuar i naftës (LPG) dhe nafta përdoren në masë më të vogël.

Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërive, ktoe



Konsumi i lartë i drurit për djeie rezulton me shpyllëzim, duke shkaktuar ndikime të jo favorshme klimatike, mjedisore, ekonomike e shëndetësore. Rreth 57% e familjeve përdorin drurin si burim ngrohjeje, rreth 39% përdorin vetëm energjinë elektrike si burim ngrohjeje, 0.5% përdorin qymyrin si burim ngrohjeje, 2% shfrytëzojnë ngrohjen qendrore dhe 2% përdorin alternativa të tjera.

Në Kosovë kërkesa për energji elektrike ndryshon sipas muajve dhe në disa kategori ky dallim është mjaft i madh. Konsumi i amvisërive është më i lartë gjatë muajve të ftohtë, kryesisht për shkak të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohjen e ambienteve. Kohët e fundit, sistemi elektroenergetik i Kosovës është përballur me presion të konsiderueshëm për shkak të rritjes së kërkesës për energji elektrike, duke rezultuar në nevojën për importe të shtrenjta të energjisë elektrike, veçanërisht gjatë sezonit të ngrohjes (tetor-mars).

Të gjeturat kryesore:

- Vizioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës është të zhvillojë një sektor energjetik pa emetim të dioksidit të karbonit CO₂ deri në vitin 2050, të integruar në tregun Pan-Evropian, duke garantuar siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përbalueshmëri për qytetarët.
- Per te arritur kete vizijon Strategjia e Energjisë nuk parasheh një impiant të ri linjiti. Kjo Strategji parasheh një rritje dinamike të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, kryesisht në teknologjinë e erës dhe atë fotovoltaike, të mbështetura me ankandet e burimeve të ripërtëritshme dhe investimet publike, si dhe pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në këtë proces. Parashihen edhe masa mjedisore në Termocentralin “Kosova B” dhe nxjerrja nga përdorimi e një ose dy njësive të termocentralit “Kosova A”.
- Vendimi për rinovimin e njësisë së dytë të Termocentralit Kosova A, do të merret më së voni në vitin 2024. Njësia (njësitë) e rinovuar(a) të termocentralit “Kosova” A” do të punojnë si rezervë strategjike nga viti 2028, që do të thotë se kjo (këto) njësi do të jetë (jenë) të disponueshme në sezonin e ngrohjes kur kërkesa për energji elektrike është më e lartë, ose në raste të jashtëzakonshme si kriza e fundit energjetike. Njësitë e Kosovës A të cilat nuk janë aktualisht në përdorim (A1 dhe A2) do të dekomisionohen, ndërsa njësia e tretë operuese e këtij termocentrali do të mbyllet përgjithmonë pasi të ketë përfunduar rinovimi i njësive të tjera të linjtit.

Gazi Natyror

- Kosova nuk ka infrastrukturë gazi apo fuqi punëtore të kualifikuar për këtë. Do të duheshin dekada për të ndërtuar një rrjet distribucioni (p.sh. për ngrohje, gatim, industri) për të arritur mbulimin e (disa pjesëve të) vendit. Duke marrë parasysh këtë dhe çmimet jashtëzakonisht të larta dhe pasigurinë ekonomike dhe gjeopolitike sa i përket furnizimit me gaz në Evropë në periudhën e luftës në Ukrainë (dhe pas saj), sigurimi i diversifikimit të burimeve të energjisë bazë ose të fleksibilitetit të sistemit përmes zhvillimit të rrjetit të gazit në vend do të ishte investim i kushtueshëm e me rrezik të lartë. Megjithatë, zhvillimet në rajon dhe botë do të ndiqen me kujdes, dhe (bashkë)investimi në impiante të energjisë nga gazi për ngarkesën bazë dhe/ose fleksibilitin e sistemit në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Greqi do të shqyrtohet me qëllim të zbatimit deri në vitin 2031.

Interkoneksioni dhe integrimi i tregut

- Integrimi i tregut me Shqipërinë është prioritet i lartë dhe veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën. Sistemet energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë janë sisteme plotësuese, termike në Kosovë dhe hidro në Shqipëri: Kosova nuk ka njësi gjeneruese për reagim fleksibil dhe të shpejtë për të shërbyer si kapacitete rezervë të sistemit, ndërsa Shqipëria ka shumë njësi të tilla. Prandaj, përdorimi i kapaciteteve ndërkufitare të transmisionit, për shkëmbimin e kapaciteteve rezervë të sistemit energjetik është reciprokisht i dobishëm.

Rritja e fleksibilitetit të sistemit

- Kosova do të instalojë së paku 170MW të kapacitetit për akumulimin e energjisë përmes baterive në sistemin e saj energjetik deri në vitin 2031. Investimi në akumulimin e energjisë jo vetëm që do të ndihmojë në përmirësimin e fleksibilitetit të sistemit dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme variable, por gjithashtu do të jetë i nevojshëm për të përmbushur kërkesat e ENTSO-E për rezervë të energjisë, dhe në një masë do të ndihmojë në uljen e importit të energjisë elektrike.

Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme

- Një objektivë tjetër e rëndësishme e politikës është arritja e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050, një zotim politik që Kosova, bashkë me 6 vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, e kanë bërë në vitin 2020 kur kanë nënshkruar Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.
- Në sektorin e energjisë, instrumentet më të rëndësishme për të diversifikuar miksin e gjenerimit do të jenë investimet në burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ulja e prodhimit të bazuar në linjit.
- Pritet se pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme në konsumin e sektorit të energjisë elektrike të rritet nga 6.3% [2021] sa është tani në 13% në vitin 2024 dhe në 35% në vitin 2031.
- Momentalisht kapacitetet e ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike (me përjashtim të prodhuesve vetë konsumues) janë 244MW ,synohet që deri në vitin 2025 ky cak të arrihet në 490MW dhe në vitin 2031 në 1300 MW.
- Ndërsa Kapaciteti i prodhuesve vetë-konsumues (prosumatorët) është vetëm 2 MW ,synohet që deri në vitin 2025 ky kapacitet të bëhet 10 MW ndërsa në 2031 të bëhet 100 MW.

Promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje

- Me strategjinë e re do të synohet promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme edhe për ngrohje. Kështuqë kapaciteti i instaluar i BRE-ve në sistemet e ngrohjes qendrore nga 15 MWth sa është tani pritet të arrihet në 85 MWth për vitin 2025

Rritja e efijencës së energjisë

- Rritja e efijencës së energjisë përmirëson sigurinë e furnizimit me energji, zvogëlon varësinë nga importi, zvogëlon barrën e konsumatorëve, dhe zvogëlon emetimet e GS-ve dhe ndotjen e ajrit.
- Me rritjen e efijencës së energjisë pritet që niveli I konsumit final të energjisë në vitin 2024 të jetë 1709 ktoe dhe deri në vitin 2031 të shkojë vetëm deri në 1877 ktoe.
- Ndërsa kursimet kumulative të energjisë nga 2.7 ktoe [2021] sa janë tani të bëhet 283 ktoe deri në vitin 2031.
- Synimi më i rëndësishëm në kuadër të efijencës së energjisë është rritja e numrit të ndërtesave më efijente, meqë ndërtesat përbëjnë afër 40% të konsumit vjetor të energjisë së vendit.
- Kjo objektivë do të arrihet me vendosjen e kërkesave minimale për energji për ndërtesat e reja, promovimit të ndërtesave me konsum të energjisë afër zero, përkrahjes për vendosjen e teknologjive me efijencë të lartë (pompat termike, sistemet termike solare, etj.), dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për masat e efijencës së energjisë.
- Synohet që kursimet totale kumulative të energjisë në ndërtesa publike nga 2.6 ktoe [2021] sa janë tani të arrihet në 3.3 ktoe për vitin 2024 dhe në 36 ktoe për vitin 2031.
- Ndërsa kursimet totale kumulative të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe komerciale synohet të arrijnë në 247 ktoe në vitin 2031.
- Në anën tjetër me përdorimin dhe vendosjen e teknologjive me efijencë të lartë (pompat termike, sistemet termike solare synohet që numri i ndërtesave me konsum të energjisë afër zero të arrihet në 150 deri në vitin 2031

Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efijente të ngrohjes qendrore

- Sistemet aktuale të ngrohjes qendrore në Prishtinë dhe Gjakovë kanë për tu zgjeruar me anë të dyfishimit të kapacitetit të kogjenerimit dhe shtimit të 70 MWth të kapacitetit të BRE-ve në ngrohjen qendrore në Termokos, me rritjen e efijencës së energjisë në rrjetin e shpërndarjes, dhe

së fundmi do të lidhen konsumatorë të rinj (publikë dhe privatë) në rrjetin e NQ, duke ndihmuar kështu në zvogëlim të konsumit të energjisë elektrike dhe zvogëlim të ndotjes së ajrit.

- Rritja e kapacitetit të kogjenerimit në “Termokos” (Prishtinë) nga 140 MWth sa është tani synohet të bëhet 280 MWth deri në vitin 2031.
- Ndërsa numri i konsumatorëve të lidhur në sistemet e ngrohjes qendrore (Prishtinë & Gjakovë) nga 17791 sa është tani synohet të bëhet 38,240 në Prishtinë dhe Gjakovë.

Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut

- Interkoneksioni dhe integrimi i tregut kontribuojnë në garantimin e sigurisë së furnizimit duke rritur besueshmërinë e sistemit energjetik, por në të njëjtën kohë ai mbështet qëllimet e përballueshmërisë dhe të konkurrencës, si dhe i bën tregjet e shitjes me shumicë dhe rezervë më kosto-efiçiente.
- Duke filluar nga viti 2024 Kosova synon ta realizoj integrimin me tregun e Shqipërisë dhe deri në vitin 2031 pret anëtarësimin në zonën e tregut Pan-Evropian.
- Me integrimin në tregjet botërore deshirohet rritja e kapacitetit të ofruar ndërkufitar nga eksporti dhe importi të arrinë nga 24-26% sa është tani në 70% për secilin drejtim.

Vlerësim dhe Sygjerime rreth ”Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës”

Me strategjinë e re të Energjisë, vizioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës është të zhvillojë një sektor energjetik pa emetim të dioksidit të karbonit CO₂ deri në vitin 2050, të integruar në tregun Pan-Evropian, duke garantuar siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përballueshmëri për qytetarët. Për të arritur këtë vizion Strategjia e Energjisë nuk parasheh një impiant të ri linjiti por parasheh një rritje dinamike të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, kryesisht në teknologjinë e erës dhe atë fotovoltaike, të mbështetura me ankandet e burimeve të ripërtëritshme dhe investimet publike, instalimin e kapaciteteve të reja për akumulimin e energjisë përmes baterive, rritjen e efiçencës së energjisë, mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë si dhe grupeve sociale të ndjeshme ndaj tranzicionit. Në anën tjetër me strategjinë e re synohet edhe Interkoneksioni dhe integrimi i tregut që do kontribuojnë në garantimin e sigurisë së furnizimit duke rritur besueshmërinë e sistemit energjetik, që në të njëjtën kohë do mbështet qëllimet e përballueshmërisë dhe të konkurrencës në treg. Të gjitha këto synime janë në përputhje edhe me kërkesat e vendeve të zhvilluara për një ekonomi më të pastër dhe për tranzicionin e gjelbert ekonomik. Megjithatë, edhe pse strategjia e re ka një vizion të qartë dhe të përshtatshëm me vizionet momentale të vendeve të zhvilluara ekonomike arritshmerija e këtij vizioni është vërtetë sfidues.

Fillimisht për arritjen e një sektori energjetik pa emetim të dioksidit të karbonit duhet të kemi një infrastrukturë adekuate institucionale dhe teknike apo plan të posaqëm që do ta mundëson këtë tranzicion. Përpos faktit që Plani i ri Kombëtar i Energjisë dhe Klimës nuk është miratuar ende nuk ka as statistika apo të dhëna të sakta mbi emetimet e karbonit për kokë banori në Kosovë. Në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës statistikën rreth emetimeve të karbonit për kokë banori në Kosovë referohet se janë marrë nga [“Raporti i Treguesve Mjedisorë të Kosovës 2020”](#) ndërsa ky raport referon se të dhënat rreth kësaj statistike janë nga data baza e Bankës Botërore. Nëse shikojmë [statistikat](#) e Bankës Botërore rreth emetimeve të karbonit për kokë banori në Kosovë mund të shohim se nuk ka të [dhëna](#). Prandaj, burimi dhe mënyra e qasjes në të dhënat mbeten të paqarta. Është shumë sfidues fakti që Strategjia e re e Energjisë për vizionin ka “tranzicionin energjetik dhe dekarbonizimin deri në vitin 2050” por nuk ka statistika rreth emetiveve

të karbonit në Kosovë. Pos kësaj edhe të dhënat e fundit që gjenden në Raportin e Treguesve Mjedisorë të Kosovës janë nga viti 2019. Pra, për ta bërë të arritshëm vizionin e Strategjisë së re të energjisë fillimisht duhet të formohet një qendër e statistikave rreth këtij objekti dhe pastaj të jetë e mundshme monitorimi i këtij vizioni. Fillimisht mungesa e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës e bën të vështirë vlerësimin se sa efektive do të jenë masat e propozuara në reduktimin e emetimeve në terma afatgjatë por gjithashtu pa statistika të sakta, transparencë dhe monitorim të të dhënave arritja e këtij vizioni do të jetë shumë sfidues.

Kur shikojmë konsumin botëror të energjisë dhe emetimet e dioksidit të karbonit nga pikëpamja sektoriale, mund të shohim se sektori i amvisërisë dhe i transportit dalin në plan të parë. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet këtyre dy sektorëve në mënyrë që të kalohet në një ekonomi pa emetime të karbonit ose në një ekonomi karbon-neutrale. Në strategjinë e re i është dhënë rëndësi e veçantë sektorit të amvisërisë ku edhe janë dhënë detajisht synimet dhe caqet e objektivit për një ekonomi më eficiente. Por megjithatë bazuar në statistika mund të shohim se si në shumicën e vendeve në zhvillim ashtu edhe në Kosovë, transporti është sektori i dytë i cili konsumon më së shumti energji pas sektorit të amvisërisë dhe mbase është një ndër sektorët që më së shumti shkakton ndotjen e ajrit në Kosovë. Prandaj pas amvisërisë, ky është një ndër sektorët kryesorë në të cilin duhet të fokusohet me raportin e ri të energjisë për të arritur vizionin e tij për një ekonomi pa emetime të karbonit deri në vitin 2050. Megjithatë, siç thuhet edhe në raportin e ri të energjisë, pjesa e burimeve të ripërtrishme të energjisë në transport është shumë e vogël. Krahasuar me rreth 333,000 makina që përdorin naftën ose benzinën si karburant, gjenden vetëm 157 automjete elektrike dhe hibride të cilat janë importuar gjatë vitit 2021. Nga ana tjetër, në vend nuk ka asnjë linjë hekurudhore të elektrizuar. Për ta bërë më të mundur këtë vizion në aspekt të sektorit të transportit mund të rivedoset mekanizma lidhur me ndalimin e importit të automjeteve të përdorura të cilat janë më të vjetra se 5 vjet. Ky aplikacion do ta bënte më të mundur reduktimin e emetimeve të karbonit në terma afatgjatë.

Përfaqësimi i BRE-ve në miksin energjetik të Kosovës është rritur në një masë gjatë viteve të fundit dhe rritja e mëtutjeshme e saj është shumë e rëndësishme për fleksibilitetin e sistemit, garantimin e sigurisë së furnizimit, kalimin në një ekonomi më të pastër, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Në anën tjetër Kosova planifikon të instalojë edhe së paku 170MW të kapacitetit për akumulimin e energjisë përmes baterive në sistemin e saj energjetik deri në vitin 2031. Investimi në akumulimin e energjisë jo vetëm që do të ndihmojë në përmirësimin e fleksibilitetit të sistemit dhe integrimin e burimeve të ripërtërishme variable por në një masë do të ndihmojë edhe në uljen e importit të energjisë elektrike. Prandaj projektet e ruajtjes së energjisë, ato të rehabilitimit të termocentraleve të vjetra si dhe ato të BRE-ve të cilat kanë për qëllim të krijojnë siguri energjetike, të zvogëlojnë çmimet e energjisë dhe të lehtësojë një tranzicion drejt energjisë së pastër në të ardhmen janë shumë jetike për sektorin e energjisë. Në këtë aspekt ne e vlersojmë shumë strategjinë e re të energjisë që ka formuar objektivat dhe ka cekur caqet e këtyre objektivave ku të gjitha kanë edhe një afat kohor për zbatim. Ne rekomandojmë që gjatë procesit të realizimit të këtyre objektivave dhe projekteve të mbahen takime konsultative me aktorët e sektorit dhe me opinionin publik. I kushtojmë rëndësi të veçantë projektimit të planit zbatues për arritjen e këtyre objektivave si dhe tenderimit të investimeve për energjinë e rinovueshme dhe atë të rehabilitimit të njësive të termocentraleve. Gjithashtu pasi që një nga instrumentet mbështetëse më të rëndësishme

të trajtuara në ligjin e ardhshëm të BRE-ve është ankandi për kapacitetet e ripërtëritshme të energjisë elektrike, sygjerojmë që aplikimet e procedurave të ankandit të jenë sa më transparente në mënyrë që të rritet shtrirja e kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme.

Opinionet dhe Sugjerimet

- Në strategjinë energjetike të qeverisë së Kosovës 2022-2031, i mirëpresim objektivat për të siguruar furnizim të pastër, të sigurt dhe me kosto efektive të energjisë. Shpresojmë që do të vazhdohet me një dialog të hapur me aktorët e sektorit dhe publikun si për investimet e reja në vend ashtu edhe për çështjet e furnizimit me energji.
- Ne mbështesim objektivin e Kosovës lidhur me arritjen e emetimeve zero të karbonit deri në vitin 2050. Mendojmë se fazat e realizimit të këtij objektiivi duhet të vendosen në një plan kohor dhe të kenë një plan veprimi, ndërsa masat që do të ndërmerren të përfshihen në këtë plan të veprimit.
- Është e rëndësishme projektimi dhe tenderimi i investimeve për energjinë e rinovueshme dhe njësive të termocentraleve, rehabilitimi i të cilëve parashikohet të bëhet sa më shpejt.
- Jemi duke i përcjellur objektivat e qeverisë lidhur me promovimin e projekteve të energjisë së rinovueshme dhe dekarbonizimin. Rekomandojmë që gjatë realizimit të këtyre objektivave të mbahen takime konsultative të rregullta me aktorët e sektorit dhe publikun, si në përcaktimin dhe zbatimin e çmimit të karbonit (taksës), ashtu edhe në procesin e realizimit të investimeve të reja.
- Mendojmë se duhet të subvencionohen projektet e efijencës dhe kursimit të energjisë. Është e rëndësishme krijimi i një fondi në këtë drejtim i cili do të përdorej edhe për të mbështetur industrinë dhe familjet.
- Shpresojmë që synimet e integritit të tregut të energjisë në Kosovë me vendet e rajonit, veçanërisht me Shqipërinë, dhe tregjet pan-evropiane të energjisë të arrihen sa më shpejt që është e mundur.
- Jemi të vetëdijshëm se kapacitetet e instaluara energjetike në Kosovë nuk i plotësojnë nevojat për energji elektrike. Prandaj ne mbështesim mirëmbajtjen dhe efijencën e termocentraleve ekzistuese dhe tenderimin e projekteve të energjisë së rinovueshme me kapacitete më të mëdha.
- Mendojmë se objektivi i qasjes së vendit në gaz natyror duhet të çohet përpara. Ne parashikojmë që studimet e fizibilitetit të infrastrukturës dhe rrjetit të konsumit të cilat janë tejet të nevojshme të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur. Sepse mungesa e gazit natyror bën që ekonomitë familjare të ngrohen kryesisht me biomasë dhe të ulin konkurrencën e objekteve industriale.
- Ne e vlerësojmë marrëveshjen në vlerë prej 202 milionë \$ që Qeveria e Kosovës ka bërë me MCC (Korporata Sfidat e Mijëvjeçarit) . Ky projekt i Ruajtjes së Energjisë që për qëllim ka sigurinë energjetike, zvogëlimin e çmimit të energjisë dhe lehtësimin e një tranzicioni drejt energjisë së pastër në të ardhmen, duke investuar në një sistem të ruajtjes së energjisë prej 350 megavatesh, mund të ndihmojë në mbushjen e zbrazëtirave energjetike për periudha të gjata. Në këtë aspekt ne rekomandojmë që gjatë procesit të realizimit të këtij projekti të mbahen takime konsultative me aktorët e sektorit në mënyrë që të bëhet punë

kolektive ku edhe do të mund të merren mendimet profesionale dhe do të formohet edhe një Know-How për investimet që mund të bëhen në këtë fushë në të ardhmen.

- Mendojmë se përmbushja e objektivave të përcaktuara në strategjinë e energjisë duhet të mbështetet një plan veprimi dhe mekanizma zbatimi. Në emër të sektorit privat, deklarojmë se jemi të hapur për bashkëpunim dhe mbështetje në ofrimin e konsultimeve të nevojshme.